

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XVIII, nr. 5660  
E shtunë, 22 dhjetor 2018  
çmimi 0.40 €

Kuvendi miraton në lexim të parë projektligjin për buxhetin e 2019-s | FAQE 9



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)



facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AKTUALE

**FOTOGRAFIA E DËSHMORIT** F. 17



Agim  
VINCA

**MEHMETRIZA MURTEZANI - MEHMET GEGA, DEMAÇI I TETOVËS** F. 11



Lulëzim ETEMAJ

**BAHTIRI: PËRPPJEKJET E MIA PËR BASHKIMIN E QYTETIT TË MITROVICËS JANË TË PARESHTURA** F. 5

## EKONOMI

**SHALA TAKON KOMUNITETIN E DONATORËVE, SHPREH GATISHMËRINË PËR VAZHDIM TË BASHKËPUNIMIT** F. 9

**DOGANA NDALON SASI TË PLUMBAVE NË AEROPORTIN E PRISHTINËS** F. 9

## KULTURË

**PROMOVHET LIBRI 'UNË E PËRDHUNUARA' E AUTORES RAMIZE MURTEZI-SHALA** F. 13



## SPORT

**ROGOVA: RIKTHIMI NË SUPERLIGË, PRIMAR** F. 18



FLET PËR "EPOKËN E RE", SAMI KURTESHI

FAQE 4-5

# Ekipi negociator nuk e përfaqëson opozitën

Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, ka bërë me dije se ekipi negociator i Kosovës për dialogun me Serbinë nuk e përfaqëson opozitën e as Kuvendin. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky mekanizëm është një lëmsh që e ka komplikuar politikën e jashtme të Kosovës. Sipas tij, PSD-ja është një subjekt politik jolegitim dhe, si e tillë, nuk mund të flasë në emër të opozitës. Kurteshi ka thënë se vendin këtij delegacioni në bisedime me Serbinë ia ka treguar shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini

## Opozita akuzon presidentin për zvarritjen e emërimit të anëtarëve të KQZ-së

Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) i kanë quajtur të panevojshme vonesat në procesin e emërimit të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga ana e presidentit Hashim Thaçi. Përfaqësuesit e këtyre dy partive opozitare e kanë akuzuar presidentin Thaçi se po bën tregti me KQZ-në për t'i shpërblyer partnerët e dialogut me Serbinë. Sipas tyre, Thaçi po tenton t'i garantojë



koalicionit qeverisës shumicën në KQZ, duke dëmtuar dhe shkelur të drejtat kushtetuese të LDK-së dhe të Vetëvendosjes



**Serbia nuk ka zbatuar shumicën e marrëveshjeve të dialogut**

FAQE 7

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegijbiznesi.com  
info@kolegijbiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302  
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

**DINO**  
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë  
tel & fax +381 38 566 666

## Pensionohet James Mattis, njeriu që dha bekimin për formimin e ushtrisë së Kosovës

WASHINGTON, 21 DHJETOR - Sekretari amerikan i Mbrojtjes, James Mattis, i cili i kishte dhënë Kosovës bekimin e Amerikës për formimin e ushtrisë, do të largohet nga posti i tij. Lajmin e ka bërë me dije përmes një postimi në llogarinë e vet në "Twitter" presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Donald Trump.

Numri një i Amerikës ka thënë se Mattis do të pensionohet në shkurt të 2019-s. Ai po ashtu përmes një postimi tjetër ka thënë se shumë shpejt do të emërohet sekretari i ri i Mbrojtjes. Mattis, 68-vjeçar, është një prej figurave më të respektuara në administratën Trump. Por, ai raportohet të jetë bërë

gjithnjë e më kundërshtues ndaj udhëheqjes së presidentit. Në veçanti, ai raportohet të mos jetë informuar për vendimin e marrë nga Trumpi të mërkurën, për tërheqjen e trupave nga Siria. "Ju keni të drejtë të keni një sekretar të Mbrojtjes, pikëpamjet e të cilit janë më në përputhje me tuajat", i ka thënë Mattis, Trumpit, në letërën e dorëheqjes.



Presidenti francez Emmanuel Macron i dërgon letër presidentit Thaçi

## Në Paris u riafirmua angazhimi për paqen

Në letërën dërguar presidentit Hashim Thaçi, homologu i tij francez Emmanuel Macron shkruan se ceremonia e shënimit të 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore ishte një mundësi për të riafirmuar angazhimin për paqen dhe gatishmërinë për forcimin e dialogut dhe veprimit kolektiv

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, i ka dërguar një letër presidentit Thaçi, përmes së cilës e ka falënderuar për pjesëmarrjen në ceremoninë e shënimit të 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, të mbajtur në Paris, më 11 nëntor 2018.

Në këtë letër dërguar presidentit Thaçi, presidenti Macron shkruan se kjo ceremoni ishte një mundësi për të riafirmuar angazhimin për paqen dhe gatishmërinë për forcimin e dialogut dhe veprimit kolektiv. "Ajo na dha mundësi ne politikanëve, të vetëdijshëm siç jemi

rreth mësimëve të së kaluarës dhe kompleksitetit të sfidave me të cilat përballemi, për të riafirmuar angazhimin për paqen dhe gatishmërinë për forcimin e dialogut në veprimit kolektiv", shkruan presidenti Macron. Kjo është përmbajtja e letërës së presidentit francez, Emmanuel Macron, "I nderuar President, kam qenë i nderuar nga prania juaj në Paris më 11 nëntor, së bashku me nën-tëdhjetë e shtatë krerë shtetesh, krerë qeverish dhe drejtues të organizatave ndërkombëtare dhe ju falënderoj përzemërisht", ka shkruar presidenti francez.



Ai ka thënë se pjesëmarrja juaj në përkujtimin e 100-vjetorit të përfundimit të Luftës së Parë Botërore dhe Forumit të Parë të Paqes në Paris ka qenë veçanërisht e rëndësishme.

"Ajo mundësoi nderimin me solemnitet dhe emocion të miliona viktimave të një tragjedie që shënjoji thellësisht kujtesën e

popujve tanë dhe orientoi fatin e botës dhe na dha mundësi ne politikanëve, të vetëdijshëm siç jemi rreth mësimëve të së kaluarës dhe kompleksitetit të sfidave me të cilat përballemi, për të riafirmuar angazhimin për paqen dhe gatishmërinë për forcimin e dialogut dhe veprimit kolektiv. Duke theksuar sërish kënaqësinë

e pamasë që pata duke ju mirëpritur më 11 nëntor 2018, si dhe mirënjohjen time për prezencën tuaj në këtë ditë kaq simbolike, ju lutem të pranoni, zoti President, shprehjen e konsideratës sime më të lartë", thuhet në letërën e presidentit francez Macron dërguar presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi.

## Studentët përmbyllin protestën për sivjet

TIRANË, 21 DHJETOR - Studentët në Shqipëri kanë përmbyllur protestat e tyre për vitin 2018, për t'i vazhduar ato në janar të vitit të ardhshëm.

Ky vendim i tyre vjen pasi që nga e hëna hapet zyrtarisht pushimi i festave të fundvitit në të gjitha universitetet e Shqipërisë.

Studentët janë zotuar që do t'i vazhdojnë këto protesta deri në plotësimin e kërkesave të tyre

ekonomike dhe akademike drejtuar qeverisë dhe institucioneve arsimore të vendit.

Prej më shumë se 2 javësh studentët kanë bojkotuar auditorët e universiteteve duke marshuar në sheshet dhe bulevardet e Tiranës por edhe në qytetet e tjera të mëdha të vendit.

Qeveria e Shqipërisë vazhdimisht ka bërë përpjekje për të hapur dialog me studentët, megjithëse



ata refuzojnë dialogun dhe thonë se kushtet e tyre nuk janë për bisedime por vetëm plotësim, se protestat e tyre nuk kanë përfaqësi

dhe se askush nuk mund të flasë në emër të protestës.

Studentët i kanë 8 kërkesa për të lehtësuar studimet e tyre, që kanë të bëjnë me ulje të tarifave, përmirësim të cilësisë së arsimit dhe të kushteve të konvikteve ku ata jetojnë, pajisjen me kartën e studentit për lehtësira ekonomike dhe përfaqësimin e tyre në borde drejtuese e vendimmarrëse të universiteteve.

Tarifat e shkollimit në universitetin shtetëror të Shqipërisë konsiderohen të jenë ndër më të lartat në rajon dhe Evropë, sa i përket shkollimit publik.

Shqipëria është një nga vendet më të varfra në Evropë me GDP prej 4,868 dollarë për kokë banori, ndërkohë që sipas Bankës Botërore në vitin 2017, është shpenzuar në arsim 2.49% të GDP, që është nën mesataren evropiane.

## PS-ja nuk e voton vettingun në politikë

TIRANË, 21 DHJETOR - Partia Socialiste rrëzoi të premten në Parlament propozimin e opozitës për të lejuar vettingun në politikë. Nisma e firmosur nga deputetët e PD-së dhe LSI-së

kërkonte ndryshime kushtetuese që të mundësonin kontrollin e pastërtisë së figurës së çdo politikani dhe deputeti, për lidhjet me krimin, pasurinë dhe korrupsionin. Me 74 vota

kundër, socialistët i thanë "jo" vettingut që do të sillte një skanim të plotë të gjithë klasës së sotme politike, duke nisur nga drejtuesit e qeverisë dhe deri të zyrtarët e tjerë të administratës.

Për këtë nismë, PD-ja dhe LSI-ja kërkuar dhe opinionin e Komisionit të Venecias, i cili parimisht u shpreh dakord një nisme të tillë edhe pse nuk është e aplikuar në shumë vende të tjera.

VOTIMI U MBYLL	
PO	.52
JO	.74
ABSTENIM	..0
PA VOTUAR	.10

Përfaqësuesit e partive opozitare kanë reaguar ndaj vonesave në procesin e emërimit të anëtarëve të rinj të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ)

# Opozita akuzon presidentin për zvarritjen e emërimit të anëtarëve të KQZ-së



Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV) i kanë quajtur të panevojshme vonesat në procesin e emërimit të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nga ana e presidentit Hashim Thaçi. Përfaqësuesit e këtyre dy partive opozitare e kanë akuzuar presidentin Thaçi se po bën tregti me KQZ-në për t'i shpërblyer partnerët e dialogut me Serbinë. Sipas tyre, Thaçi po tenton t'i garantojë koalicionit qeverisës shumicën në KQZ, duke dëmtuar dhe shkelur të drejtat kushtetuese të LDK-së dhe të Vetëvendosjes

që nga 27 mars i këtij viti duke e defunksionalizuar këtë institucion kushtetues.

Kryetari Mustafa ka bërë me dije se LDK-ja është e vendosur të mbrojë të drejtën e saj për përfaqësim adekuat në KQZ në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në rast të mos materializimit të kësaj të drejte do ta referojë çështjen në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Edhe Lëvizja Vetëvendosje në një konferencë për medie ka kritikuar presidentin Thaçi për vonesat e shkaktuara për emërimin e anëtarëve të KQZ-së. Anëtari i Kryesisë së Lëvizjes Vetëvendosje, Xhelal Sveçla, ka thënë se presidenti Thaçi, së bashku me bashkëpunëtorët negociatorë, PDK-në, AAK-në, Nismën dhe PSD-në, kanë degraduar dhe kapur KQZ-në. "Përbërja dhe funksionet e KQZ-së duhet të shihen nga këndvështrimi i ndikimit në integritetin e zgjedhjeve, besueshmërinë e paanshmërinë

e procesit zgjedhor dhe ndërtimit të konsolidimit të demokracisë nëpërmjet garës elektorale të subjekteve politike që kanë marrë pjesë në zgjedhje dhe që kanë qenë të certifikuar nga ana e KQZ-së në zgjedhjet e fundit. Kjo është norma dhe fryma që mbartë Kushtetuta e Republikës, e veçmas e ligjit për zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë. Andaj, çfarëdo cenimi i integritetit të KQZ-së, siç po bën presidenti Thaçi, është cenim i demokracisë dhe shkelje e rëndë e ligjit dhe e Kushtetutës së Republikës", ka theksuar Sveçla. Sipas tij, mandatet në KQZ nuk kanë të bëjnë me Kuvendin, por me rezultatin e zgjedhjeve.

Sveçla ka thënë se, sipas rezultateve të zgjedhjeve të 11 qershorit 2017, koalicioni PAN do të duhej t'i ketë dy anëtarë, Lëvizja Vetëvendosje dy anëtarë dhe koalicioni LAA dy anëtarë. Ndërkaq anëtarja e kryesisë dhe deputetja Albulena Haxhiu ka thënë se procedurat e emërimit të anëtarëve të KQZ-së janë

shumë të qarta. Ajo ka thënë se Hashim Thaçi nuk mund ta përdorë zyrën e presidentit për t'ia mohuar opozitës përfaqësimin që ka marrë nga votuesit në zgjedhje dhe që garantohet me ligj e Kushtetutë.

Haxhiu ka bërë me dije se Vetëvendosja në përputhje me Kushtetutën dhe Ligjin për Zgjedhje ka dorëzuar te presidenti dy nominime, Adnan Rustemin dhe Nazlie Balen, për anëtarë të KQZ-së. Ajo ka kërkuar nga presidenti që sa më parë t'i konfirmojë dy anëtarët e propozuar të KQZ-së që do të përfaqësojnë Lëvizjen Vetëvendosje në këtë mandat dhe të tërhiqet nga skenarët e tij për ta tregtuar përbërjen e KQZ-së. "Çfarëdo vendimi tjetër, përveç atij që na garanton Kushtetuta, Ligji për Zgjedhjet dhe rezultati i zgjedhjeve të 11 qershorit, do të jetë i papranueshëm dhe do të kontestohet në të gjitha rrugët ligjore dhe kushtetuese", ka deklaruar Haxhiu.

**EPOKA E RE** Shqipe HETEMI

**PRISHTINË, 21 DHJETOR** - Ndonëse është bërë një vit e gjysmë që nga certifikimi i zgjedhjeve parlamentare të 11 qershorit, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) vazhdon të jetë jofunksional për shkak të mosemërimit të anëtarëve të rinj. Për këto vonesa kanë reaguar të premten dy partitë opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK)

dhe Lëvizja Vetëvendosje (LV). Sipas opozitës, presidenti Hashim Thaçi po bën tregti me KQZ-në për t'i shpërblyer partnerët e dialogut me Serbinë. Kryetari LDK-së, Isa Mustafa, të premten u ka përcjellë ambasadorëve të shteteve të Kuintit, OSBE-së dhe Zyrës së BE-së në Prishtinë, një letër në të cilën ka sqaruar qëndrimin e kësaj partie rreth tendencave të presidentit Thaçi për zvarritjen e emërimit të anëtarëve të KQZ-së

## Kosova merr kryesimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor

**PRISHTINË, 21 DHJETOR** - Republika e Kosovës do të marrë kryesimin e Fondit të Ballkanit Perëndimor nga 1 janari i vitit 2019. Kjo është vendosur në takimin e Këshillit të Zyrtarëve të Lartë të Fondit të Ballkanit Perëndimor, i cili është

mbajtur më 19 dhe 20 dhjetor në kryeqytetin e Republikës së Shqipërisë, Tiranë. Fondi i Ballkanit Perëndimor është organizatë ndërkombëtare e themeluar nga gjashtë qeveritë e Ballkanit Perëndimor për ta pro-

movuar bashkëpunimin në rajon. Objektivi kryesor i këtij Fondi është që ta fuqizojë bashkëpunimin në mes të anëtarëve të vet dhe kohezionin rajonal me projekte të ndryshme me qëllim të avancimit të procesit të integritimeve evropiane.



Flet për "Epokën e re", Sami Kurteshi

# Ekipi negociator nuk e



Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, ka bërë me dije se ekipi negociator i Kosovës për dialogun me Serbinë nuk e përfaqëson opozitën e as Kuvendin. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se ky mekanizëm është një lëmsh që e ka komplikuar politikën e jashtme të Kosovës. Sipas tij, PSD-ja është një subjekt politik jolegjitim dhe, si e tillë, nuk mund të flasë në emër të opozitës. Kurteshi ka thënë se vendin këtij delegacioni në bisedime me Serbinë ia ka treguar shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini

**EPOKA  
ERE****Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 21 DHJETOR** - Deputeti i Lëvizjes Vetëvendosje, Sami Kurteshi, ka kritikuar ekipin negociatar për bisedime me Serbinë të miratuar në Kuvend javën e kaluar. Ai ka thënë se ky mekanizëm nuk e përfaqëson as Kuvendin dhe as opozitën. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Kurteshi ka thënë se ai është një lëmsh. "As nuk është delegacioni i Kuvendit, as i Qeverisë, por i përzier me kryetarë komune, përfaqësues të shumtë të një 'grupi' apo një subjekti politik jolegjitim në Kuvend - PSD-së, që nuk e ka kaluar pragun zgjed-

hor në zgjedhjet parlamentare e, për më keq, 'flet' në emër të opozitës, përfaqësues të shoqërisë civile, të personave brenda Qeverisë pa deputetë, apo në rastin më të mirë të përfaqësuar me një deputet. Ky ekip negociator i bërë 'lëmsh thiu' mund të përfaqësojë çdo gjë tjetër, vetëm Kuvendin nuk përfaqëson. Opozitën gjithsesi jo", ka thënë Kurteshi. Sipas tij, vendin këtij delegacioni në procesin e dialogut ia ka treguar shefja e politikës së jashtme e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini. "Tanimë vendin dhe pozitën e këtij 'delegacioni shtetëror', fatkeqësisht e ka paracaktuar komisionarja e KE-së, Mogherini, në letrën drejtuar

kryeministrit Haradinaj. Shkurt e shqip thënë, nëse e përkthejmë në shqipen popullore, Mogherini 'delegacionin shtetëror' të votuar më 15 dhjetor 2018 e quan bisht të Hashim Thaçit. Këtë e dëshmon vetë koha e votimit, ditës së votimit, të cilën, shikuar nga perspektiva e sotme, e kishte preferuar vetë Thaçi", është shprehur ai. Kurteshi e ka komentuar edhe letrën e presidentit amerikan Donald Trump për presidentin Hashim Thaçi. Ky i fundit, sipas tij, e ka keqpërdorur këtë letër për interesa personale. "Pikërisht kjo letër sqaron mashtrimin, preferencën e Hashim Thaçit për kohën e votimit të rezolutës dhe ekipit

# përfaqëson opozitën

vota kundër apo abstenime, nuk jam krejt i sigurt tani. Bashkë me këtë dokument është votuar edhe një ekip për dialogun, të cilin e kanë emërtuar si 'delegacion shtetëror' për dialogun. Me këtë është kompletuar kakofonia kosovare në politikën e jashtme, me theks të veçantë në 'dialogun me Serbinë'. Politikë të jashtme bëjnë Pacolli, Thaçi, Haradinaj, Veseli e tani edhe Shpend Ahmeti e Fatmir Limaj, pa i numëruar këtu edhe të tjerët. Një lëmsh i bërë 'lëmsh', i cili mund të zgjidhet vetëm me zgjedhje të reja dhe kthim i politikës së jashtme në binarët institucionalë. Dokumenti i rezolutës së miratuar thuhet se duhet të përcillet apo pasohet edhe nga një ligj. Pra, ligji për çka? Dialogun!? Pra, nuk mjafton rezoluta e mbështetur në Kushtetutë, por duhet edhe një ligj për dialogun! Sigurisht më vonë do të kërkohet edhe ndonjë dokument shtesë, sepse këto të gjitha nuk do të mjaftojnë, ngaqë do të shohim se ky ishte një manipulim i radhës i pushtetit të korruptuar dhe të kriminalizuar të Hashim Thaçit, i cili karrierën e ka ndërtuar me shkelje dhe mashtrime.

**"Epoka e re":** Me këtë rezolutë është votuar edhe ekipi negociator, i cili do të bashkëkryesohet nga Shpend Ahmeti dhe Fatmir Limaj. A mund ta përfaqësojë Kosovën ky delegacion në këtë proces?

**Kurteshi:** Tanimë vendin dhe pozitën e këtij 'delegacioni shtetëror' e ka paracaktuar komisionarja e KE-së, Mogherini, në letrën drejtuar kryeministrit Haradinaj. Shkurt e shqip thënë, nëse e përkthejmë në shqipen popullore, Mogherini 'delegacionin shtetëror' të votuar më 15 dhjetor 2018 e quan bisht të Hashim Thaçit. Këtë e dëshmon vetë koha e votimit, ditës së votimit, të cilën, shikuar nga perspektiva e sotme, e kishte preferuar vetë Thaçi. Përndryshe, ky ekip negociator është një lëmsh sikurse edhe vetë politika e jashtme e Kosovës, një kakofoni institucionale e radhës par excellence. As nuk është delegacion i Kuvendit, as i Qeverisë, i përzier me kryetarë komune, përfaqësues të shumtë të një 'grupimi' apo një subjekti politik jolegjitim në Kuvend - PSD-së, që nuk e ka kaluar pragun zgjedhor në zgjedhjet parlamentare e, për më keq, 'flet' në emër të opozitës, përfaqësues të shoqërisë civile, të personave brenda Qeverisë pa deputetë, apo në rastin më të mirë të përfaqësuar me një

deputet. Ky ekip negociator i bërë 'lëmsh thiu' mund të përfaqësojë çdo gjë tjetër, vetëm Kuvendin nuk përfaqëson. Opozitën gjithsesi jo.

**"Epoka e re":** Pse Lëvizja Vetëvendosje nuk do të bëhet pjesë e dialogut dhe delegacionit shtetëror negociator?

**Kurteshi:** Lëvizja Vetëvendosje bëhet pjesë vetëm e veprimeve të cilat Kosovës i sjellin përparim, mirëqenie, siguri, prodhim vendor, arsim, shëndetësi, drejtësi dhe ekonomi të mirë. Por Lëvizja Vetëvendosje kurrë nuk bëhet pjesë e veprimeve që cenojnë e rrezikojnë shtetësinë, integritetin territorial dhe sovranitetin e Republikës së Kosovës.

**"Epoka e re":** Presidenti

amerikan Donald Trump i ka dërguar një letër presidenti Thaçi, në të cilën kërkon nga spektri politik vendor të jetë unik për marrëveshjen historike me Serbinë. Si duhet të trajtohet mesazhi i kësaj letre nga partitë politike?

**Kurteshi:** Kjo letër sqaron mashtrimin, preferencën e Hashim Thaçit për kohën e votimit të rezolutës dhe ekipit negociator për dialogun me Serbinë. Përndryshe, edhe një kërkesë fisnike të administratës amerikane për paqe në raportet Kosovë - Serbi, 20 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, Hashim Thaçi e ka konsumuar për shou medial e politik, me faktin e fshehtë, gjegjësisht nxjerrjes së saj në momentin e caktuar, disa ditë më vonë. Ky njeri gjithçka e sheh nga dioptria

e një shou medial e politik për përfitime personale, gjithnjë duke e ndjerë ftohtësinë e 'shpatës së Demokleut', Gjykatës Speciale, në gropëzën e qafës prej gënjeshtari dhe mashtruesi kronik, të cilën praktikisht e ka shtyrë përpara kundër 'shokëve' të vet të luftës. Populli thotë, 'kush i bën gropën tjetrit, bie vetë në të!'

**"Epoka e re":** Në çfarë mënyre do ta kundërshtojë LV-ja këtë fazë të dialogut me Serbinë?

**Kurteshi:** Në mënyrë të vendosur, parimore, pa kompromise të kalbura, sikurse ka bërë gjithmonë deri më tani. LVV-ja ndërmerr veprime vetëm pasi t'i ketë analizuar mirë e mirë, duke i peshuar në peshoren e interesit të përgjithshëm dhe në etikën politike.

## Bahtiri: Përpyjekjet e mia për bashkimin e qytetit të Mitrovicës janë të pareshtura

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

**MITROVICË, 21 DHJETOR** - Kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka mbajtur të premtën tryezë të përbashkët me qytetarë, me ç'rast janë iniciuar procedurat e peticionit për bashkimin e qytetit të Mitrovicës. Të pranishëm në këtë takim ishin nënkryetari i komunës, Faruk Mujka, kryesuesi i Kuvendit Komunal, Jeton Ujkani, drejtorët e drejtorive komunale, asamblistë të partive politike si dhe një numër i konsiderueshëm i qytetarëve.

Kryetari i komunës, Agim Bahtiri, ka falënderuar për praninë e qytetarëve duke theksuar se gjithmonë për çdo vendim të Komunës së Mitrovicës është konsultuar me qytetarë. "Sot ju kam ftuar për të debatuar së bashku për një iniciativë të cilën

e kemi miratuar edhe në Kuvendin Komunal me qëllim të bashkimit të Mitrovicës. Përpyjekjet e mia si kryetar i komunës kanë qenë të pareshtura për bashkimin e qytetit duke ndërmarrë të gjitha masat dhe duke përdorur mënyrat më legjitime për t'iu drejtuar institucioneve qendrore. Dhe, siç e dini edhe ju, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka kthyer kërkesën tonë për bashkimin e Mitrovicës si jo legjitime, edhe pse ne i kemi drejtuar Qeverisë së Kosovës, e pastaj ajo ta nxjerrë te Kuvendi i Kosovës. Sot ju kam ftuar këtu mbi bazën e ligjshmërisë që të iniciojmë peticionin duke iu drejtuar Kuvendit të Kosovës për ta bashkuar qytetin e Mitrovicës. Prandaj ju falënderoj që çdoherë më keni qëndruar pranë", ka thënë Bahtiri.

Kryetari Bahtiri edhe një herë i

ka falënderuar qytetarët për përkrahjen. "Kërkoj nga ju të dalim faqebardhë me këtë peticion e t'i drejtohem në mënyrë legjitime Kuvendit të Kosovës. Nuk do të ketë parti politike, por do të jemi ne për të gjithë. Peticioni fillon të hënën. Dhe, në qoftë se dikush do të ketë hamendje që nuk do të realizohet, gabon, sepse do të realizohet. Ju lus, si qytetar i Mitrovicës, t'i dilni zot vendit tuaj, dhe ditën e hënën t'i përgjigjen vullnetarisht dhe masivisht iniciativës sime", është shprehur Bahtiri.

Ky peticion u përkrah nga të gjithë të pranishmit që morën pjesë aty, ndërsa më të zëshmit ishin banorët e fshatit Kçiq i Madh, Gushafç, Frashër i Madh, Kushtovë, fshatrat e rajonit të Shalës së Bajgores, të cilët e përkrahën këtë iniciativë të kryetarit Bahtiri për bashkimin e Mitrovicës.



negociator për dialogun me Serbinë. Përndryshe, edhe një kërkesë fisnike të administratës amerikane për paqe në raportet Kosovë - Serbi, 20 vjet pas përfundimit të luftës në Kosovë, Hashim Thaçi e ka konsumuar për shou medial e politik, me faktin e fshehtë, gjegjësisht nxjerrjes së saj në momentin e caktuar, disa ditë më vonë", ka thënë Kurteshi.

**"Epoka e re":** Kuvendi tashmë ka miratuar rezolutën për dialogun me Serbinë. Cili është komenti juaj për këtë dokument?

**Kurteshi:** Miratimi i kësaj rezolute tanimë është një fakt i kryer. Kjo rezolutë është votuar nga pozita, me 59 vota për dhe 2

## Siguria kibernetike mbetet interesim i lartë i MPB-së

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB), Këshilli për Siguri Kibernetike, i udhëhequr nga Koordinatorin Nacional për Siguri Kibernetike, Selami Shkodra, ka mbajtur takimin planifikues për të diskutuar rreth zbatimit të projektit për siguri kibernetike (C3K), projekt i Programit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP-së), Projektit të Kosovës për Siguri (KSSP), financuar nga Qeveria e Norvegjisë. Me këtë rast zëvendësministri Shkodra ka përsëritur se siguria kibernetike është me prioritet të lartë në agjendën e MPB-së dhe, sipas tij, janë duke u bërë përpjekje serioze për ta rritur sigurinë kibernetike dhe përmirësuar sjelljen tonë kibernetike kombëtare. Ai ka theksuar se ka ende shumë punë për të bërë dhe se ndërtimi i sigurisë kibernetike do të jetë një përpjekje afatgjatë. Ndërsa Alain Lapon nga UNDP




KSSP ka prezantuar projektin C3K, duke shpjeguar se si ky projekt do ta forcojë sigurinë kibernetike në Kosovë përmes zbatimit të një fushate të informimit për popullatën e përgjithshme. Ai ka pohuar se përmes këtij projekti do të përfitojnë për personat juridikë që kanë dhe menaxhojnë infrastrukturën kritike të infor-

macionit, ofrojnë softuerë dhe trajnime profesionale të certifikuar për Ekipet Reaguese për Emergjencë Kompjuterike (CERT) në kuadër të Policisë së Kosovës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ofrojnë zhvillim të kapaciteteve në hetimet në internet dhe darknet për përfaqësuesit e përzgjedhur nga Policia e Kosovës.

Gjatë takimit anëtarët u shprehën të gatshëm të ofrojnë bashkëpunim dhe sollën një perspektivë unike dhe të fuqishme për problemet e sigurisë kibernetike. Në fund zëvendësministri Shkodra ka theksuar se Këshilli do të ofrojë mbështetje të pakursyer për implementimin e aktiviteteve konkrete dhe ka

kërkuar nga anëtarët e Këshillit mbështetje dhe bashkëpunim për realizimin dhe arritjen e rezultateve të përbashkëta. Projekti C3K parashihet të implementohet brenda periudhës dyvjeçare dhe do të realizohet në partneritet të ngushtë me Këshillin Shtetëror të Sigurisë Kibernetike, MPB-në dhe Policinë e Kosovës.

## Promovohet libri 'Unë e përdhunuar' e autores Ramize Murtezi-Shala



PRISHTINË, 21 DHJETOR - Në librarinë "Dukagjini", të premtën në Prishtinë, është promovuar libri "Unë e përdhunuar" e autores Ramize Murtezi-Shala. Në këtë promovim morën pjesë personalitete nga jeta politike, e kulturës dhe përfaqësues të shoqërisë civile. Ramize Murtezi-Shala, autore e librit, ka thënë se ideja për promovimin e këtij libri ka ardhur nga puna që e ka bërë ajo dhe nga rrëfimet që i ka dëgjuar nga gra dhe burra të dhunuar. Ajo ka treguar se libri flet për betejën jetësore të një nëne të përdhunuar gjatë luftës bashkë me dy vajzat e saj, njëra dhjetëvjeçare, tjetra shtatëvjeçare, për ta sjellë drejtësinë në vend dhe betejën për ta thyer heshtjen. Autorja ka treguar se ky libër bazohet në ngjarje të vërtetë. "Në këtë libër janë rrëfimet. Në libër është rasti konkret. Është një nënë me dy vajza të mitura, njëra 10-vjeçare, tjetra shtatëvjeçare, të

cilat dhunohen brutalisht. Njerëzit duhet të mësojnë më shumë për historinë e këtyre grave, të tregojnë për jetën në të cilën ato kanë jetuar për këta 20 vjet", ka thënë ajo. Murtezi-Shala ka thënë se në fillim nuk ka menduar se ky libër do të vlerësohet për t'u botuar. "Kam filluar të shkruaj vetëm nga ajo që ndieja si obligim për këto gra, shumë më shumë për rastin konkret, normalisht edhe për rastet e tjera. Kam filluar të shkruaj dhe njerëzit më kanë shtyrë dhe më kanë thënë se duhet të vazhdoj. E kam përfunduar krejt shkrimin, pastaj jam konsultuar me profesorët dhe ata më kanë shtyrë për ta përfunduar punën", ka treguar autorja e këtij libri Ramize Murtezi-Shala. Ajo ka bërë me dije se gjatë shkrimit të librit nuk e ka pasur lehtë. "Buqja (Vasfije Krasniqi Goodman) ka qenë ajo që e ka thyer akullin. Unë kam folur me

Buqen dhe ajo më tregoi se gratë e tjera i janë lajmëruar asaj. Ka raste të tjera që janë lajmëruar edhe në KRCT. Pas intervistës së Vasfijes, situata ka ndryshuar shumë në rastet e familjeve të Kosovës që janë dhunuar", ka deklaruar Ramize Murtezi-Shala. Autorja e librit Ramize Murtezi-Shala ka bërë me dije se ky libër do të botohet edhe në gjuhë të tjera. Është bërë me dije se të gjitha mjetet që do të grumbullohen nga shitja e librave do të shkojnë për kategorinë e atyre grave që janë dhunuar. Gjatë promovimit ka folur Vasfije Krasniqi-Goodman, ku përmes një videolidhje ka përgëzuar autoren për botimin e këtij libri. Me një fjalë rasti është paraqitur edhe prof. Rrahman Paçarizi, ambasadorja Vlora Çitaku, psikiatrja Mimoza Shahini dhe drejtoresha e KRCT, Feride Rushiti. Çmimi i librit gjatë promovimit ishte me -20% zbritje.

## Kosova vlerëson mbështetjen e ShBA-së për sektorin e sigurisë

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministri i Punëve të Brendshme, Ekrem Mustafa, ka pritur të premtën në takim njoftues ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Philip Kosnett. Në këtë takim, ministri Mustafa e ka njoftuar ambasadorin amerikan për situatën e përgjithshme të sigurisë në Kosovë. Gjatë këtij takimi u diskutua për marrëdhëniet dhe bashkëpunimin në

mes të ShBA-së dhe Republikës së Kosovës. Ministri Mustafa ka vlerësuar lart mbështetjen që qeveria amerikane ka dhënë për sektorin e sigurisë, veçanërisht për përkrahjen për fuqizimin e agjencive të sigurisë në kuadër të ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ka kërkuar që kjo përkrahje të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndërsa



ambasadori amerikan Philip Kosnett ka thënë se vendi i tij është i përkushtuar për bashkëpunimin me Republikën e Kosovës, duke shtuar se ndihet shumë i gëzuar që do të shërbejë në Kosovë. Ai ka theksuar se bashkëpunimi dhe përkrahja amerikane për Republikën e Kosovës, në veçanti për institucionet e rendit dhe ligjit, nuk do të mungojë.

# Serbia nuk ka zbatuar shumicën e marrëveshjeve të dialogut

Pas monitorimit, komisionet parlamentare të Kuvendit të Kosovës kanë konkluduar se Serbia nuk ka zbatuar shumicën e marrëveshjeve të dialogut. Kjo u bë me dije të premtën në takimin e katërt koordinues, të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës, rreth rolit monitorues dhe mbikëqyrës të Kuvendit në procesin e dialogut Kosovë - Serbi

EPOKA  
ERE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI), në bashkëpunim me Komisionin Parlamentar për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike, kanë mbajtur takimin e katërt koordinues të komisioneve parlamentare të Kuvendit të Kosovës rreth rolit monitorues dhe mbikëqyrës të Kuvendit në procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Në këtë takim u diskutua mbi punën që komisionet parlamentare kanë zhvilluar në funksion të monitorimit të zbatimit të marrëveshjeve që dalin nga procesi i dialogut, duke përfshirë të gjeturat, të arriturat dhe sfidat për zbatimin e këtyre marrëveshjeve të cilat janë evidentuar edhe në Raportin e Qeverisë të qershorit të këtij viti mbi këtë çështje.

Kryetarja e Komisionit për Punë të Jashtme, Vjosa Osmani, në fillim të takimit ka kërkuar që në planet e punës të vitit 2019, çështjes së dialogut t'i kushtohet rëndësi, duke përfshirë aktivitete të ndryshme mbikëqyrëse të këtij procesi. Sipas saj, nga vlerësimi që Komisioni për Punë të Jashtme i ka bërë raportit të qeverisë mbi sfidat dhe të arriturat për zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit, del se Serbia nuk ka

zbatuar gati dy të tretat e marrëveshjeve të arritura deri më tani, për dallim nga pala e Kosovës e cila ka treguar gatishmëri dhe përkushtim, duke zbatuar pothuajse të gjitha marrëveshjet.

Jeta Krasniqi nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka sqaruar se KDI-ja prej më shumë se dy vjetësh ka ofruar mbështetje konstante ndaj Kuvendit të Kosovës, komisioneve dhe grupeve parlamentare lidhur me procesin e dialogut Kosovë - Serbi. Duke vlerësuar punën që komisionet parlamentare të Kuvendit kanë bërë gjatë vitit 2018, ajo ka theksuar se komisionet parlamentare mund të luajnë rol shumë më efektiv dhe proaktiv për ushtrimin e funksionit mbikëqyrës në raport me procesin e dialogut.

Gjatë takimit, nga deputeti Muharrem Nitaj u ngre edhe çështja e zhvillimeve të reja në dialog, përkatësisht mbi rezolutën e re të Kuvendit të Kosovës mbi fazën finale të dialogut, e cila parasheh, ndër të tjera, krijimin e Komisioni për mbikëqyrjen e dialogut, duke shtuar se mbetet të shihet edhe vetë e ardhmja e marrëveshjeve tashmë të arritura në kuadër të këtij procesi.

Ndërsa deputeti Driton Selmanaj ka kritikuar këtë qasje, duke e



vlerësuar si kundërligjore, meqenëse rezoluta e re tenton ta përjashtojë aktivitetin mbikëqyrës të komisioneve parlamentare, të cilat janë të parapara në Rregulloren e Punës së Kuvendit të Kosovës.

Në vazhdim kryetarët e komisioneve parlamentare raportuan mbi aktivitetet mbikëqyrëse që komisionet përkatëse kanë ndërmarrë që nga takimi i fundit koordinues lidhur me procesin e dialogut. Disa nga marrëveshjet për të cilat u raportua nga komisionet parlamentare ishin marrëveshja për drejtësi, marrëveshja për energji, marrëveshja për krijimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, marrëveshja për revitalizimin e urës mbi lumin Ibër, marrëveshja për energjinë, marrëveshja për telekomunikacionin, marrëveshja për Fondin Zhvillimor për Veriun, marrëveshja për lëvizjen e lirë, marrëveshja për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (IBM), marrëveshja për vulat doganore,

marrëveshja për produkte farmaceutike, marrëveshja për shpërbërjen e së ashtuquajturës "mbrojtja civile", marrëveshja për njohjen e diplomave, marrëveshja për regjistrat kadastralë dhe civilë dhe marrëveshje të tjera.

Të gjitha komisionet evidentuan sfida të shumta për zbatimin e marrëveshjeve të caktuara, kryesisht për shkak të obstrukcioneve dhe mosgatishmërisë për zbatim nga ana e Serbisë. U deklarua se një nga marrëveshjet e cila po zbatohet në nivele të kënaqshme është ajo për produktet dhe pajisjet farmaceutike në kuadër të së cilës janë regjistruar 123 produkte farmaceutike serbe të cilat kanë pranuar ligjet në fuqi të Kosovës. Gjatë diskutimeve u përmend edhe çështja e anëtarësimit të KOSTT-it në ENTSO-E, për të cilën u tha se është dështuar qëllimisht nga pala e Kosovës, duke qenë se marrëveshja e propozuar nga ENTSO-E parashihte vendosjen e kufirit energjetik të Kosovës te Liqeni i

Ujmanit, duke e lënë këtë të fundit nën menaxhimin dhe kontrollin energjetik të shtetit të Serbisë.

Kryetarët e komisioneve parlamentare u pajtuan që komisionet të paraqesin raport me shkrim lidhur me monitorimin e zbatimit të marrëveshjeve të caktuara nga procesi i dialogut dhe të njëjtat të diskutohen në këtë format të takimit. Në këtë takim u artikulua nevoja për kujdes të shtuar, sidomos për integrimin e personave me të kaluar kriminale në sistemin e drejtësisë dhe Policinë e Kosovës për shkak të dyshimeve se të njëjtat kanë qenë të përfshirë në krime të kryera gjatë periudhës së luftës në Kosovë.

Komisionet parlamentare u pajtuan që gjatë vitit të ardhshëm, në varësi të zhvillimeve të reja në kuadër të procesit të dialogut, ta vazhdojnë bashkëpunimin në mes të tyre, duke mbajtur qoftë edhe takime të përbashkëta, gjatë rasteve kur diskutohen çështje të cilat ndërlidhen me dialogun Kosovë - Serbi.

## Limaj takon ambasadorin italian: Kosova po hyn në dialog me objektiva të qarta

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Bashkëkryesuesi i delegacionit shtetëror të Kosovës për bisedimet me Serbinë, Fatmir Limaj, ka pritur në takim ambasadorin e Italisë në Kosovë, Piero Cristoforo Sardi. Limaj e ka njoftuar ambasadorin italian për takimet e para që delegacioni shtetëror po i zhvillon disa ditë pas votimit në Kuvendin e Kosovës.

Ambasadori Sardi tha se Italia e përkrah fuqishëm delegacionin shtetëror të votuar në Kuvendin e Kosovës. Ai ka thënë se Kosova ka bërë një hap të madh me votimin e këtij delegacioni dhe se Roma inkurajon Kosovën ta vazhdojë dialogun me Serbinë. Bashkëkryesuesi Limaj e ka njoftuar se delegacioni ka mbajtur mbledhjen e parë konstituive ku janë marrë disa vendime, siç

është ai për ta përgatitur platformën apo parimet për bisedime me Serbinë. Limaj e ka njoftuar edhe për takimet e delegacionit me kryetarin e Kuvendit, Kadri Veseli dhe kryeministrin Ramush Haradinaj.

Ideja e këtyre takimeve, sipas Limajt, është koordinimi i aktiviteteve dhe marrja e gjithë informacioneve dhe dokumentacionit se çka është biseduar deri më tani me Serbinë. Limaj e ka siguruar ambasadorin italian se delegacioni do të jetë në koordinim të plotë me institucionet të tjera. Limaj ka deklaruar se Kosova futet në këtë dialog me objektiva të qarta: arritjen e një marrëveshjeje përfundimtare e cila çon në njohje reciproke dhe mundëson anëtarësimin e Kosovës në OKB dhe në organizata të tjera ndërkombëtare.



## Kuvendi Komunal i Skenderajt miraton planin e punës së ekzekutivit për 2019-n

SKENDERAJ, 21 DHJETOR (ER) - Kuvendi Komunal i Skenderajt ka mbajtur seancën e fundit për këtë vit, në të cilën janë shqyrtuar dhe miratuar të gjitha pikët e rendit të ditës. Si më të rëndësishme, në këtë mbledhje janë veçuar planet e punës së Kuvendit Komunal, përfshirë ai i Komitetit për Politikë dhe Financa dhe i ekzekutivit për

vitin e ardhshëm, të cilat, pas diskutimeve të anëtarëve të Kuvendit, janë miratuar. Gjithashtu, janë përkrahur edhe raporti i punës së Personelit për vitin 2017 si dhe rekomandimet e Komitetit për Mbrojtje dhe Shpëtim si dhe është miratuar propozim-rregullorja për tatimin në pronë të paluajtshme për vitin 2019.



## Selmanaj, Jashari dhe Ramosaj shpërndajnë dhurata për fëmijët e Deçanit dhe të Skenderajt

DEÇAN, 21 DHJETOR (ER) - Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, Shpëtim Selmanaj, së bashku me kryetarin e Komunës së Skenderajt dhe atë të Deçanit, Bashkim Ramosaj, kanë shpërndarë dhurata për fëmijët e disa shkollave në këto dy komuna. Selmanaj ka bërë me dije se këto dhurata janë bërë me kontributin e punëtorëve të kësaj agjencie. "Sot, së bashku me kryetarin e

Komunës së Skenderajt, z. Bekim Jashari dhe me kryetarin e Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, shpërndamë dhurata për fëmijët të blera me kontributin e punëtorëve të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Shpërndarja e dhuratave është bërë për fëmijët e shkollës në Aqarevë të Komunës së Skenderajt si dhe për fëmijët e shkollës në Glllogjan të Komunës së Deçanit. Falënderoj kryetarët e

komunave përkatëse, Bekim Jasharin dhe Bashkim Ramosajn, për bashkëpunimin e tyre, veçanërisht falënderoj drejtorin z. Bahri Nuredini dhe punëtorët e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, të cilët kontribuuan me mjetet e tyre financiare që festat e fundvitit të jenë më të hareshme për fëmijët e këtyre dy fshatrave", ka shkruar Selmanaj në llogarinë e vet në "Facebook".



## Premtohet mbështetje për Shoqatën e Shurdhmemeceve

FERIZAJ, 21 DHJETOR (ER) - Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, e shoqëruar nga shefi i kabinetit të kryetarit Selim Marevci, drejtori i infrastrukturës, Arbër Bytyqi, këshilltarja komunale Lumnije Morina nga PDK-ja dhe Balton Derguti nga LDK-ja, kanë vizituar Shoqatën e Shurdhmemeceve në Ferizaj. Me këtë rast drejtuesit e kësaj shoqate këta të fundit i kanë njoftuar me problemet dhe sfi-

dat me të cilat përballet kjo kategori. Naser Maliqi, kryetar i Shoqatës së Shurdhmemeceve në Ferizaj, është shprehur se problem kryesor, përveç kushteve të rënda të jetës, është edhe ndalja e pensioneve invalidore që po bëhet nga ana e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Ai ka kërkuar nga drejtuesit e qeverisë lokale që të bisedojnë me nivelin qendror në mënyrë që t'i dalin sadopak në ndihmë kësaj kategorie.

Ndërsa kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Ferizajt, Kristina Gashi-Bytyçi, por edhe shefi i kabinetit të kryetarit Selim Marevci, ka premtuar mbështetje më të madhe për këtë kategori përdërisa ka shtuar se me rregulloren e re e cila u dedikohet personave me aftësi të kufizuara, e cila pritet të miratohet në mbledhjen e radhës së kuvendit të komunës, është e përfshirë edhe kjo kategori. Në Komunën e Ferizajt janë rreth 180 persona shurdhmemece.

## Komuna e Junikut kundër marrjes së burimeve të ujit nga Komuna e Gjakovës

JUNIK, 21 DHJETOR (ER) - Në mbledhjen e rregullt të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS), me pëlqimin e qeverisë komunale të Junikut, anëtarëve të KKS-së, OJQ-ve dhe bizneseve u mor vendim që të procedohet një peticion me nënshkrimet e të gjithë qytetarëve të Junikut ku do t'i drejtohen kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj, që të ndalë çdo veprim të Ministrisë së MMPH-së, Komunës së

Gjakovës dhe KRU Gjakova, të cilët po tentojnë të marrin në mënyrë të paligjshme dhe në kundërshtim me konventat ndërkombëtare të ujërave, burimin e ujit të Erenikut të vogël, për rezultat: ndaljen e lumit, shkatërrimin e ekosistemit natyror, florën dhe faunën, bërjen e tokave bujqësore djerrina, lënien pa ujë të pijes për qytetarët e Komunës së Junikut me rrethinë, përfundimisht vdekjen e lumit "Erenik".





## Kuvendi miraton në lexim të parë projektligjin për buxhetin e 2019-s

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Me 62 vota për, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë miratuar të premtën në parim projektligjin rreth buxhetit për vitin 2019. Kuvendi i Kosovës ka debatuar para disa ditësh, për dy ditë rresht, rreth buxhetit të propozuar nga Qeveria e Kosovës.

Megjithatë, debati pati përfunduar pa votimin e projektligjit, pasi Kuvendi nuk ka pasur kuorum për vendimmarrje.

Buxheti për vitin 2019 është paraparë ta arrijë shifrën e 2.3 miliardë eurove.

Ky projektbuxhet nuk është mbështetur nga dy partitë

opozitare, Lidhja Demokratike e Kosovës dhe Lëvizja Vetëvendosje, mirëpo ka fituar përkrahjen e subjektit tjetër opozitar, Partisë Socialdemokrate. Pas shqyrtimit në komisionet përkatëse pritet që Kuvendi ta vendosë këtë projektligj për miratimin final në fillim të javës së ardhshme.



## Shala takon komunitetin e donatorëve, shpreh gatishmërinë për vazhdim të bashkëpunimit

EPOKA  
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 21 DHJETOR - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë (MTI), Endrit Shala, ka mbajtur takim me komunitetin e donatorëve, duke shprehur mirënjohje për ndihmën e vazhdueshme që kanë dhënë për Qeverinë e Kosovës dhe MTI-në. Ai ka theksuar se mbështetja e donatorëve është shumë e nevojshme për rrugën e Kosovës drejt Bashkimit Evropian. "Mirënjohje të thellë në radhë të parë për ndihmën e

vazhdueshme nga donatorët, të cilët kanë mbështetur Qeverinë e Republikës së Kosovës, e sidomos Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë. Aktualisht jemi duke punuar në disa projekte që mbështesin zhvillimin e bizneseve si dhe zhvillimin e politikave tregtare dhe të industrisë të cilat do të kenë impakt në përmirësimin e jetës së qytetarëve. Për më tepër, procesi i integritimit evropian për Kosovën përbën vlerën fundamentale dhe prioritetin kryesor të vendit drejt aderimit në familjen e madhe

evropiane", ka thënë Shala, duke shtuar se masat e parapara në agjendën evropiane dhe zbatimin e tyre nga institucionet vendore është udhërrëfyesi kryesor i Kosovës në aspektin e zhvillimit ekonomik dhe në përgjithësi prosperitetin e vendit. "Në këtë kontekst, mbështetja e donatorëve, duke përfshirë këtu ndihmën e drejtpërdrejt financiare dhe ekspertizën, janë më se të nevojshme", ka deklaruar Shala. Ai ka bërë me dije se edhe në vitin që po vjen do ta vazhdojnë punën duke pasur prioritet

implementimin e MSA-së dhe përmirësimin e ambientit të të bërit biznes. "Të nderuar donatorë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë në vitin 2019 do të vazhdojë të punojë duke pasur prioritet implementimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit, përmirësimin e mëtejshëm të ambientit të të bërit biznes, fuqizimin e infrastrukturës së cilësisë, zhvillimin e turizmit vendor, si dhe mbrojtjen e konsumatorit duke e përmirësuar mbikëqyrjen e tregut. Për detaje e keni edhe broshurën

para vetes që i potencon aktivitetet konkrete që MTI i planifikon t'i ketë prioritet gjatë vitit 2019", u shpreh Shala. Ai ka shprehur gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit me qëllim të avancimit të politikave shtetërore drejt zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik. "Si përfundim, më lejoni ta shpreh edhe një herë mirënjohjen për bashkëpunimin dhe mbështetjen e vazhdueshme, njëkohësisht t'jua rikonfirmojmë gatishmërinë për bashkëpunim në të ardhmen", ka deklaruar Shala.

## Dogana ndalon sasi të plumbave në Aeroportin e Prishtinës

PRISHTINË, 21 DHJETOR (ER) - Oficerët doganorë kanë kapur një sasi të konsiderueshme të fishekëve gjatë tentimkontrabandës në pikëkalimin kufitar - aeroport. "Zyrtarët doganorë në Aeroportin e Prishtinës kanë ndaluar një pasagjer i cili po fluturonte nga Gjermania.

Personi në fjalë ka kaluar nëpër kanalën e gjelbër nga ku është selektuar për kontrollim të valixhes. Pas imazheve në skaner oficerët kanë vërejtur se personi transportonte gjësende të dyshimta. Është kërkuar edhe kontrolli fizik i valixhes. Gjatë kontrollimit të

valixhes është gjetur mall i ndaluar: Plumba të kalibrit 9mm - 250 pce. Pas zbulimit oficerët kanë ndaluar personin dhe plumbat dhe rasti është përcjell tutje për trajtim nga Policia e Kosovës dhe prokuroria", thuhet në njoftimin e Doganës së Kosovës.



Në 50-vjetorin e demonstratave të vitit 1968 në Tetovë

# Mehmetriza Murtezani - Mehmet Gega, Demaçi i Tetovës



Lulëzim ETEMAJ

Pa asnjë kusht duhen pastruar gjermanët dhe hungarezët nga rrethet e Vojvodinës, po ashtu edhe shqiptarët nga Kosova dhe Maqedonia. Luftërat janë më të volitshme për zgjidhjen e këtyre problemeve. Ato si ndonjë stuhi shkulin nga rrënjët dhe shfarosin popuj. Ajo që gjatë periudhave të paqes duhet të zgjidhet me dekada e shekuj, gjatë kohëve të luftërave shtetërore zgjidhet për pak muaj dhe pak vite. Kjo është formula e referatit të kryeideologut të shovinizmit serb Vasa Çubriloqi, me titull "Problemi i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re", të paraqitur më 3 nëntor 1944, i cili iu dorëzua për zbatim dhe zgjidhje të këtij problemi Kuvendit të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë si dhe Ushtrisë Nacional Çlirimtare të Jugosllavisë. Në fakt, ky referat për nga fryma shoviniste shkon përtej referatit "Shpërngulja e shqiptarëve", të hartuar po nga Çubriloqi, të mbajtur më 7 mars të vitin 1937 në Klubin e Kulturës Serbe në Beograd, i cili, në shënjestrën e dëbimit dhe shkatërrimit si të tillë, pra në fokus të gjenocidit i kishte vënë shqiptarët e mbetur jashtë Shqipërisë, në Kosovë dhe në treva të tjera shqiptare, fillimisht si pasojë e vendimit të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1912-1913) e më pastaj edhe të Konferencës së Paqes së Versajës, të organizuar nga katër vendet kryesore fituese të Luftës së Parë Botërore: ShBA-ja, Britania, Franca, Italia, e cila i filloi punimet më 18 janar 1919 dhe zgjati 12 muaj.

Dy vjet më vonë, në vitin 1939, qeveria jugosllave "Arnautëve", siç i quan Çubriloqi në elaboratin e tij shqiptarët me përbuzje, ua gjen edhe vendin për t'i dëbuar, Turqinë. Sipas marrëveshjes së arritur në mes të këtyre dy shteteve, Jugosllavia për 40.000 familje shqiptare të Kosovës dhe trevave të tjera shqiptare do t'ia paguante Turqisë shumën prej 20 milionë lirave turke.

Rostusha); Dibra (Dibër); Struga (Strugë); Graçanica (Prishtinë); Kaçaniku (Kaçanik); Gjilani (Gjilan); Presheva (Preshevë); Prespa (Resnja); Poreçi (Juzhni Brod-Makedonski Brod); Prilepi (Prilep); Manastiri (Manastiri); Kavadarci (Kavadari); Marihova (Manastiri-Marihovë); Negotini (Negotini i Vardarit); Shkupi; Kumanova (Kumanovë); Velesi (Velesi); Ovçe Pole (Ovçe Pole); Radovishtë (Radovishta); Strumica; Dojrani (Valandova); Gjevgjelija (Gjevgjelija); Kriva Pallanka (Kriva Pallanka); Kratova (Kratovë); Carevo Sello (Carevo Sello); Malësi (Berovë); Peja (Pejë); Istogu (Istog); Mitrovica; Gjakovë; Përdrinia (Rahoveci); Llapi (Podujevë); Vushtrria dhe Drenica, këto janë qytetet, përfshirë edhe vendbanimet e tyre, të banuara me shqiptarë, të ndara në tri banovina, të cilat duhet të spastroheshin etnikisht në funksion të jetësimit të konventës jugosllavo-turke për t'u serbizaruar përmes popullimit me kolonë serbë. Sipas një përlogaritjeje të thjeshtë, nisur nga mesatarja e numrit të anëtarëve që në atë kohë mund të kishte një familje shqiptare, e cila shquhej kryesisht për numrin e madh, bëhet fjalë për numrin prej afër 200-300 mijë shqiptarëve që do të duhej të dëboheshin nga trojet e veta stërgjyshore.

Një vit para se Vasa Çubriloqi ta paraqiste referatin e parë, 7 mars 1937, më 26 shkurt 1936, u lind në Prishtinë Adem Demaçi, ndërsa Mehmetriza Murtezani-Mehmet Gega, i lindur më datën 23 nëntor 1921 në Tetovë, tashmë i kishte mbushur 16 vjet dhe mund edhe të mos kishte dëgjuar ende për elaboratin e Çubriloqit apo të mos kishte informacione më të sakta mbi të, porse në këtë moshë do të ketë pasur njohuri nga përvoja jetësore për shtypjen e egër gjenocidale të Mbretërisë Serbo-Kroate-Sllavene (1918-1941) që po ushtrohej kundër shqiptarëve. Në thellimin e këtyre njohurive dhe në kundërshtimin e fuqishëm dhe të organizuar të dëbimit të shqiptarëve, detyrimin të tyre për t'u deklaruar si turqë dhe ndalimit të shkollimit në gjuhën shqipe, që ua bënte mbretëria sllave, Mehmet Gegës, do t'i ketë shërbyer anëtarësimi i hershëm në organizatën patriotike "Besa", të themeluar në Tetovë në vitin 1938, kryetar i së cilës ishte emëruar Ibrahim Ibrahim. Kështu, si Mehmet Gega në Tetovë, ashtu dhe Adem Demaçi në Prishtinë më vonë, në vend të heshtjes, karrierës personale dhe rehatisë, e zgjodhën herët, qenë rininë e hershme,

rrugën e kundërshtimit të shtypjes dhe dëbimit të shqiptarëve nga trojet e tyre etnike për në Turqi, kryesisht shkretëtirat e Anadollit.

Përhapja e propagandës midis myslimanëve, se ata kurrsesi nuk mund të jenë turq, por janë vetëm shqiptarë; përhapja e idesë për Shqipërinë etnike dhe lufta për bashkimin e shqiptarëve në Kosovë, Preshevë, Bujanovc dhe Maqedoni si dhe kushtimi i rëndësisë mësimin të gjuhës shqipe, historisë dhe kulturës shqiptare, këto ishin tri nga shtyllat kryesore të programit politik kombëtar të organizatës "Besa".

Në kohën kur shovinisti Vasa Çubriloqi paraqet referatin e dytë, "Problem i pakicave kombëtare në Jugosllavinë e re", më 3 nëntor të vitit 1944, Mbretëria SKS ishte zëvendësuar nga Republika Popullore Federative e Jugosllavisë, kurse Mehmet Gega i kishte mbushur 23 vite, ndërsa si pasojë e Luftës së Dytë Botërore, ishte ndërprerë përkohësisht edhe dëbimi i shqiptarëve.

"Marrëveshja xhentelmene" ndërmjet Jugosllavisë së Titos dhe Turqisë, në vitin 1953, ripërtinë marrëveshjen e vitit 1938, i jep fund ndërprerjes së përkohshme të dëbimit të shqiptarëve dhe e rikonfirmon vullnetin e titullarëve të rinj të Beogradit për ta vazhduar dhe çuar përpara gjenocidin e filluar përmes shtypjes, dëbimit nga trojet e veta të mbetura nën Jugosllavi dhe shkatërrimit të tyre si shqiptarë që ishin. Faktikisht kjo marrëveshje paraqet vetëm aktin final të zyrtarizimit të

dëbimit të dhunshëm të shqiptarëve në mënyrë që trojet e tyre të popullëzoheshin edhe më tutje me kolonë serbë dhe malazezë. Sigurisht që as në rastin e parë dhe as në të dytin, krerët e Jugosllavisë, si të parës ashtu dhe të dytës, nuk ishin të marrë që faqe botës të ekspozoheshin si dëbues të shqiptarëve. Prandaj përmes rregullave të emigrimit, do të saktësonin se Konventa përfshinte popullatën turke, e që faktisht fjala ishte për dëbimin e shqiptarëve të konfesionit mysliman. Prandaj, në shërbim të fshehjes së politikave të dhunshme shpopulluese ndaj shqiptarëve, në po të njëjtin vit, pra në vitin 1953, gjatë regjistrimit të popullsisë zyrtarë e gjendjes civile do të ushtrojnë trysni të fortë mbi shqiptarët për ta ndërëruar përkatësinë e tyre kombëtare nga ajo shqiptare në atë turke.

Si rezultat i dhunës dhe terrorit të pashembullt, në periudhën kohore 1951-1959 vetëm nga Maqedonia në Turqi ishin dëbuar gjithsejtë 143.800 banorë mysliman, e që në fakt pjesa dërmuese e tyre ishin shqiptarë.

## Adem Demaçi: Mehmet Gega është hero i vërtetë i kombit tonë

Ashtu siç po përpiquej tani Jugosllavia e Titos ta realizonte me çdo mjet politikën gjenocidale të Jugosllavisë së vjetër kundër shqiptarëve, kishin mbetur të pashuar edhe përpjekja dhe lufta e Mehmet Gegës, kundër kësaj politike. Të njëjtin luftë tashmë po e bënte me

shumë përkushtim edhe Adem Demaçi në Prishtinë.

Si rezultat i këtij angazhimi atdhetar, jo vetëm në Tetovë, Gostivar, Strugë, Shkup, por edhe në Pejë, Prizren, Mitrovicë dhe Gjilan, Mehmet Gega, arrestohet nga UDB-ja maqedonase më 21 maj të vitit 1955 në qytetin e Shkupit dhe dënohet me 10 vite burgim të rëndë, prej të cilave i mbanë shtatë dhe lirohet në vitin 1962.

Përderisa Mehmet Gega po e vuante dënimin në burg për veprimtari armiqësorë ndaj shtetit, më 19 nëntor 1958 burgoset në Prishtinë Adem Demaçi. Në gjykimin e mbajtur në mars të vitit 1959, Gjykata e Qarkut e Prishtinës e dënon Demaçin me pesë vite burgim të rëndë. Para se të arrestohej, Demaçi e boton në revistën "Jeta e Re" në vitin 1958 romanin e parë, "Gjarpijt e gjakut". "Gjarpijt e gjakut" në të vërtetë është romani i parë shqiptar në Kosovë. Ky është romani që i shqiptoi dënimin vendimtar gjakmarrjes, njëkohësisht që paraqet akuzë kundër shoqërisë, e cila nuk po ndërmerre asgjë për çrrënjosjen e saj. Prandaj pushteti e shpalli roman të ndaluar sepse e pengonte ndërprerja e vrasjes së shqiptarëve në mes vete dhe bashkimi i tyre, dhe kushdo që tinëziste e lexonte apo dhe e shpërndante këtë roman për ta lexuar, e priste arrestimi, torturat dhe burgu. Në kohën e liritimit të Mehmet Gegës nga burgu i Idrizovës, dëbimi i shqiptarëve në Turqi thuajse ishte ndërprerë plotësisht. Tashmë, lufta e tij duhej intensifikuar dhe zhvilluar në një drejtim krejt tjetër, jo në atë të mbijetesës fizike në trojet e tyre të të parëve, por në avancimin e të drejtave kombëtare, përmes ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe të shkallës së organizimit për ta bërë Shqipërinë e zhbërë, duke ia bashkangjitur pjesët e shkëputura padrejtësisht të trunqut të saj.

Më 27 prill 1969, gazeta "Rilindja", duke e botuar një raport të Agjencisë Shtetërore të Lajmeve të Jugosllavisë, "Tanjug", e themeluar më 5 nëntor 1943, pas shpërbërjes së Jugosllavisë e trashëguar nga Serbia e Millosheviqit ndërsa nga viti 2006 e shndërruar në agjenci shtetërore të lajme e Serbisë, e njohur në të gjitha kohërat si njëra nga shtyllat më të fuqishme të propagandës shoviniste antishqiptare, e njoftonte opinionin me akuzën e grupit të arrestuar për organizimin e demonstratave të Tetovës të 22 dhe 23 dhjetorit 1968.

(Fusnotat i ka hequr redaksia /Vijon)



# Narkoza e vizave - mit apo realitet (2)



Shkruan: Agron HOTI

## Vallja e kriterëve

"Heqja e kufijve, garantimi i sigurisë dhe ndërtimi i besimit morën shumë vite pas dy luftërave botërore shkatërruese. Krijimi i zonës së Shengenit është një nga të arriturat më të mëdha të BE-së dhe, si e tillë, është e pakthyeshme. Tani lëvizja e lirë e bën Evropën më të vogël dhe na bashkon. Hyni në tren apo futuri në veturë dhe vizitoni fqinjët tuaj. E tëra është e mundshme pa menduar shumë për kufij" / Dimitris Avramopoulos, komisionar për migracion, çështje të brendshme dhe qytetari nga Komisioni Evropian. Kjo deklaratë shkon drejt frymës së synuar të BE-së. Nuk duhet haruar që kriteret e përgjithshme për procesin e integritimit evropian, përfshirë lëvizjen e lirë, janë shumëfishuar aq shumë sa, po të nxirrnim sot nga BE dhe hapësira Shengen, p. sh. Gjermaninë, Francën apo Italinë, do të ishte e pamundshme për këto shtete që të futen prapë, pikërisht për disa kriteret të vështira, të cilat këtyre shteteve nuk u janë kërkuar t'i plotësojnë, sepse ishin vetë këto shtete që filluan procesin e integritimit evropian dhe çdo iniciativë tjetër eurointegruese. Ç'është e vërteta, ato as sot nuk i plotësojnë këto kriteret.

P. sh., kryeprokurori i Shtetit edhe sot është nën ingerencat e ekzekutivit në Francë, Itali, Gjermani etj., pastaj lufta ndaj korrupsionit dhe krimin të organizuar as që ishte temë kur pati filluar procesi i integritimit evropian. Atëbotë të gjitha shtetet kishin vetëm një brengë e që ishte siguria e qytetarëve të tyre dhe zhvillimi ekonomik, sepse Evropa ishte pothuaj tërësisht e shkatërruar nga Lufta e Parë dhe e Dytë Botërore.

Në një gjendje të tillë ku Evropa ishte ende në gjermadha, ishte e pamundur të krijosh shtet efektiv të rendit dhe ligjit, së paku jo brenda 10 vjetëve siç po i kërkohej Kosovës, sepse një ndërmarrje e tillë brenda 10 vjetëve është më shumë sesa utopi. E kur kësaj i shtojmë edhe rentabilitetin e ulët të zhvillimit ekonomik, i cili edhe sot mbretëron jo vetëm në Kosovë, por në tërë Ballkanin, atëherë

çdo zhvillim nëpër segmente të caktuara të shtetit do të ecë tepër ngadalë pa marrë parasysh dëshirën e kombinimeve të ndryshme politike.

As Kosova nuk mund të ishte përjashtim nga shtetet anëtare të BE-së, të cilat, pas Luftës së Dytë Botërore, kishin vetëm një brengë të vetme: sigurimin e kafshatës së gojës, diçka që e patëm përjetuar tmerrësisht edhe në Kosovë. Prandaj, të kesh vetëm 10 vjet shtet dhe ta kesh dyfishin e kriterëve për liberalizimin e vizave krahasuar me vendet e rajonit, do të përbente sfidë edhe për shtete që ekzistojnë që mbi 150 apo 300 vjet. Ndërkohë që e kaluara e Kosovës është aq e dhimbshme sa që qytetari evropian i shekullit XXI as që mund ta paramendojë një tragjedi të tillë njerëzore, çfarë u pati ndodhur qytetarëve të Kosovës nga pushtimi klasik i Serbisë. Pra, shikuar të kaluarën e rëndë historike të Kosovës, sigurisht se duket më tepër se tragjikomike e herë-herë absurd vazhdimi i pakuptueshëm i maratonës së mosliberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës, si të vetmit qytetarë të kontinentit të vjetër që nuk mund të udhëtojnë të lirë. Absurdi bëhet edhe më i madh kur trendet e komunikimit dhe hapjes së botës janë duke u rritur me parametra të jashtëzakonshëm, ndërkohë që qytetarët e Kosovës kanë mbetur pothuaj tërësisht të izoluar.

## Vlera jonë

Shqiptarët, prej pas Luftës së Dytë Botërore, edhe pse nën pushtim jugosllav, vazhdimisht janë solidarizuar me zhvillimet që për synim kishin bashkimin e Evropës. Represioni i vazhdueshëm jugosllav mbi popullsinë shqiptare kishte pikërisht për synim shuarjen e shpirtit evropizues që dominonte mes shqiptarëve atëherë dhe sot. Të gjitha lëvizjet e shqiptarëve ishin edhe më pro-evropiane sesa vetë lëvizjet e ndryshme brenda Evropës Perëndimore dhe asaj Lindore.

Pa rënies së komunizmit, shqiptarët - edhe pse të vetëdijshëm që nuk mund të çlirohen nga Serbia me rrugë paqësore - përqaftuan lëvizjen çlirimtare paqësore karshi agresorit serb, diçka që Evropa nuk e kishte parë më parë, kjo sepse vlera e çlirimit paqësor s'ishte evropiane, ajo bazën e kishte në Indi, edhe pse lëvizja paqësore e Kosovës vetëm në formë, por jo në përmbajtja i ngjasonte asaj indiane.

Dhe Evropa, duke mos pasur një vlerë të tillë në vete, nuk e vlerësoi atë asnjëherë si dhe sa duhet,

edhe për faktin se këtë vlerë e zbatonte një popull, pra populli shqiptar, që në sytë e Evropës vazhdimisht ishte dukur si popull periferik. E kur rruga paqësore si vlerë joevropiane nuk u dëshmuar si efektive, atëherë shqiptarët e Kosovës filluan të zbatojnë ato metoda të cilat i kishin përdorur vetë kombet evropiane për çlirim - luftën e armatosur. Të gjitha këto lëvizje kishin një synim të vetëm, pavarësimin e Kosovës si hap drejt arritjes së paqes në Ballkan. Ashtu siç vazhdimisht është thënë në pothuaj të gjitha qarqet e ndryshme vendore e ndërkom-betare, shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 ka konfirmuar katërçipërisht faktin se ka kontribuar dukshëm në demokratizimin dhe evropizimin e mëtejshëm të Ballkanit në veçanti dhe të Evropës në përgjithësi. Si duket ky kontribut i pashoq i qytetarëve të Kosovës asnjëherë s'u mor mjaftueshëm parasysh nga qarqet e ndryshme të BE-së dhe shteteve anëtare të saj. Vetë fakti që pavarësia e Kosovës solli paqe dhe stabilitet në rajon është e arritur e madhe për Ballkanin dhe Evropën që me shekuj kishin gërryer vetveten.

Lëvizja e lirë e qytetarëve të Kosovës patjetër se do të jetë vlerë e shtuar për Evropën sepse duke qenë trekonfesional dhe shumetnik siç bashkëjetojmë në tolerancë e acceptancë - që nuk ia gjen shembullin jo vetëm në Evropë - kemi avantazh të theksuar karshi paragjykimeve dhe stereotipave ndërkonfesionale, ndëretnike dhe ndërkulturore ekzistuese gjithandej Evropës dhe globit.

Përparësitë e theksuara që Kosova ua ofron komuniteteve joshumicë në të gjitha dimensionet e zhvillimit shoqëror dhe njerëzor nuk është se mund të hasen shumë në rajonin tonë

(që lëviz pa viza) dhe gjithandej nëpër Evropë. Dhe kjo përbën vlerë për shoqërinë e Kosovës, para së gjithash për rajonin, Evropën dhe njerëzimin në përgjithësi.

## Imuniteti i BE-së

Tashmë dihet se BE-ja është duke u përballur me katër probleme, secili më i vështirë se tjetri. Kriza financiare së cilës nuk po i shihet fundi, kriza e refugjatëve, dezintegrimi territorial i BE-së siç po ilustron nga Brexit dhe masat restriktive që janë duke penguar zhvillimin ekonomik të BE-së. Të gjitha këto probleme nuk është se mund të adresohen për një kohë të shkurtër, ndërkohë që sa më gjatë që zgjasin aq më e pasigurt do të bëhet BE-ja. Vetë fakti që bisedimet për Brexitin janë duke vazhduar pa fund, tregon për goditjen që ka marrë projekti evropian.

Data 29 mars 2019 do të jetë koha kur Britania e Madhe zyrtarisht do ta fillojë largimin nga BE-ja dhe kjo pritet të zgjasë së paku deri në fund të vitit 2020. Britanisë i konvenon që pas daljes nga BE-ja të ketë politika tregtare të pavarura që mundësojnë marrëveshje për tregti të lirë, ndërkohë që BE-ja e kushtëzon që, së paku, deri në vitin 2021 Britania të mbetet brenda Unionit Doganor të BE-së, duke mos i lejuar Britanisë gjatë kësaj periudhe të bëjë marrëveshje tregtare të pavarura.

Britania e Madhe kërkon që të mos kontribuojë në buxhetin vjetor të BE-së me shumën të "mëdha" financiare, ndërkohë që BE si faturë të daljes i kërkon një shumë prej 40 miliardë funtesh për pagesa të ardhshme. Pra, kjo tregon se sa energjinë janë duke shpenzuar BE-ja dhe Britania e Madhe për t'u

'shkurorëzuar' mes vete. Britania e Madhe fillimisht kishte hezitime të anëtarësohej në BE, pastaj mendohej të hynte, por s'e lejonte Franca. Edhe kur hyri, përpos në tregun e përbashkët, kurrë nuk hyri në Shengen dhe Eurozonë, kurse krejt në fund vendosi ta braktisë BE-në.

Pra, BE-ja, sado që është munduar të japë ndjenjë se brenda saj të gjithë janë të barabartë, kjo asnjëherë në praktikë nuk u realizua. Jorastësisht shumë autorë e quajnë "Evropa e shpejtësive të ndryshme". Qasja e BE-së edhe ndaj aspirantëve asnjëherë nuk ka mundur të jetë e njëtrajtshme. Kjo është manifestuar në mënyra të ndryshme gjatë procesit të integritimit evropian dhe procesit të liberalizimit të vizave. Krizat e ndryshme, përfshirë krizën financiare të vitit 2008, të cilën evropianët ua adresojnë amerikanëve, vetëm sa e thelluan qasjen jokohërente të BE-së ndaj aspirantëve.

Ndërkohë që, edhe Kosova, ashtu sikurse e gjithë Evropa, nuk ka mundur të jetë imune ndaj zhvillimeve globale, sidomos pas krizës financiare globale të vitit 2008. E në këto zhvillime Evropa jo rrallëherë është ndier dhe ende ndihet e cenueshme nga aktorë joevropianë, sidomos nga Rusia, Kina dhe jo vetëm.

Këta aktorë joevropianë, në radhë të parë Rusia, kanë filluar të ndërhyjnë në zgjedhjet elektorale të vendeve të ndryshme të BE-së, pra kanë filluar ta godasin zemrën e demokracisë evropiane. Nuk është e rastësishme rritja e ndikimit të forcave nacionaliste populiste brenda për brenda shteteve anëtare të BE-së duke u bërë pothuajse forca e tretë politike në shtete të caktuara.

(Vijon)



## Trumpi mund ta tërheqë gjysmën e trupave nga Afganistani



UASHINGTON, 21 DHJETOR - Sipas njoftimeve, presidenti Donald Trump po shikon mundësinë e një tërheqjeje të konsiderueshme të trupave amerikane nga Afganistani, afërsisht gjysmën e më shumë se 14 000 trupave të vendosura atje. Sipas planit, rreth 7 000 trupa amerikane do të kthehen në SHBA në muajin janar, ndërsa pjesa tjetër në muajt e ardhshëm, në një

tërheqje me faza.

Trupat amerikane janë pjesë e një force të NATO-s, që nuk është e angazhuar në luftime, misioni kryesor i së cilës është trajnimi dhe këshillimi i forcave afgane për marrjen e përgjegjësisë për garantimin e sigurisë në vend.

Administrata Trump po përpiket për një zgjidhje të negociuar për t'i dhënë fund

luftës në Afganistan, që përfshin zhvillimin e bisedimeve me talebanët.

Në letrën e dorëheqjes së tij dorëzuar presidentit Trump, sekretari i Mbrojtjes, Jim Mattis, nuk përmendi në mënyrë të posaçme Afganistanin, por shkruante se presidenti gëzon të drejtën për të pasur një sekretar Mbrojtjeje, pikëpamjet e të cilit përpunohen me të tjerat.

# Drejtimi që do të marrë populizmi në Evropë në vitin 2019

Vala populiste mund të ketë implikime të mëdha në zgjedhjet e Parlamentit Evropian, të parashikuara për t'u mbajtur në vitin 2019, ku forcat centriste përballen me sulme si nga e djathta, ashtu edhe nga e majta. Në fund të vitit 2018 populizmi në Evropë ka një ngjyrë të re: të verdhë

BRUKSEL, 21 DHJETOR - Forcat populiste u kthyen fuqishëm në Evropë në vitin 2018, duke marrë pushtetin në Itali dhe duke u konsoliduar në vende si Hungaria dhe Polonia. Në Francë protestat nëpër rrugë shpërthyen me kërkesa për dorëheqjen e presidentit. Vala populiste mund të ketë implikime të mëdha në zgjedhjet e Parlamentit Evropian, të parashikuara për vitin 2019 ku forcat centriste përballen me sulme si nga e djathta, po ashtu edhe nga e majta.

Në fund të vitit 2018, populizmi në Evropë ka një ngjyrë të re: të verdhë.

Lëvizja e "Jelekëve të verdhë" shpërtheu në Francë, si protestë kundër taksave për karburantin dhe u shndërrua në demonstrata në gjithë vendin.

"Bëhet fjalë për njerëz të vërtetë, jo njerëz që shtiren sikur janë diçka që nuk janë", thotë Jean-Francois,

një protestues.

Presidenti Emmanuel Macron, që dikur shihej si njeriu që frenoi marshimin e populizmit, u tërhoq duke shtyrë ngritjen e taksave.

Ç'do të thotë kjo? Që populizmi është kthyer në forcë politike. "2018-a ishte viti i rikthimit të valës. Unë mendoj se ishte gabim të besohej se vala ishte ndaluar. Në fakt thjesht ishte fshehur pas Macronit", thotë Gregory Claeys, i Institutit Bruegel për Politika.

Por populizmi i 2018-s ka një ndryshim. E djathta ekstreme dhe e majta ekstreme marshuan së bashku. "Më parë shihnim populizëm të krahut të djathtë, kryesisht në Evropën Lindore, falë frikës së imigracionit dhe çështjeve të identitetit, ndërsa në jugun e Evropës kishim më shumë populizëm të majtë sepse ky është rajoni që është prekur më shumë nga kriza financiare, kriza e euros e të tjera. Prandaj të dyja janë si të



veçanta, por tani shikojmë në vende si Italia dhe Franca, i kemi të dyja njëkohësisht", thotë Claeys.

Kjo lloj bashkëjetese u zyrtarizua në Itali, kur Lëvizja e krahut të majtë Pesë Yjet dhe Liga e së djathtës ekstreme formuan një qeveri koalicioni në maj.

Kauza e tyre e përbashkët: ndalja e valës së imigrantëve në brigjet ital-

iane dhe ndërprerja e shkurtimit të shpenzimeve. Kjo e ka vënë Romën në konflikt me Bashkimin Evropian.

Ministri i Brendshëm, Matteo Salvini, që shihet këtu me udhëheqësen e së djathtës ekstreme të Francës, Marie Le Pen, është bërë fytyra e populizmit kundër BE-së. "Armiqtë e Evropës janë ata që janë mbyllur në bunkerin e

Brukselit", thotë ai.

Tronditur nga tërmetet politike, Bashkimi Evropian ka paralajmëruar se liritë themelore janë në shënjestër. "Jetojmë në një botë të karakterizuar nga rilindja e forcave populiste dhe retorikës shkatërruese", shprehet Antonio Tajani, presidenti i Parlamentit Evropian.

Në Spanjë, që dikur shihej si e imunizuar nga politika e së djathtës ekstreme, partia populiste "Vox" po forcohet. "Këto lëvizje politike nuk do të shuhet. Ato do të jenë këtu për dekada të tëra", tha ai.

Por populsitët kanë konkurrencë. Partia e Gjellbër proevropiane është fuqizuar në Gjermani, duke e ulur Alternativën për Gjermaninë të së djathtës ekstreme në vend të katërt. Në Hungari, protestat e rrugëve kanë shpërthyer kundër qeverisë populiste të Viktor Orbanit.

Copëzimi i politikës evropiane mund të ketë implikime të mëdha për zgjedhjet e Parlamentit Evropian në maj 2019. Pasi kanë fituar terren në disa kryeqytete në gjithë Evropën, në vitin 2019 forcat populiste do të përpiqen t'i marrin frenat e pushtetit edhe në vetë Bashkimin Evropian.

## Ankaraja përshëndet vendimin amerikan për tërheqjen nga Siria



VALETA, 21 DHJETOR - Ministri i Punëve të Jashtme të Turqisë, Mevlut Çavusoglu, deklaroi se Ankaraja përshëndet vendimin e SHBA-së për të tërhequr trupat e saj nga Siria.

"Në lidhje me vendimin e tërheqjes së SHBA-së nga Siria, ne e mirëpresim këtë vendim", u shpreh Çavusoglu në një konferencë të përbashkët për medien me homologun e tij maltez,

Carmelo Abela, në Valeta të Maltës.

Kryediplomati turk, theksoi se Turqia mbështet plotësisht integritetin territorial të Sirisë. Ai po ashtu pohoi se Turqia ka luftuar ISIS-in për shumë vite.

"Ne besojmë se ISIS-i është mundur, por ende duhet të jemi shumë vigjilentë, sepse ISIS-i dhe grupet e tjera radikale ende janë në terren", tha Çavusoglu.

Çavusoglu po ashtu tha se "ai dhe zyrtarë të tjerë turq kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë në kontakt me zyrtarët e SHBA-së në nivele të ndryshme për këtë çështje".

Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, të mërkurën urdhëroi të gjitha forcat amerikane në Siri të tërhiqen nga vendi, duke theksuar se disfata e ISIS-it ishte arsyeja e vetme për praninë amerikane në vendin e shkatërruar nga lufta.

## Izraeli thotë se po shkatërron tunele terroriste të Hezbollahut

TEL-AVIV, 21 DHJETOR - Izraeli po shkatërron ato që thotë se janë tunele terroriste të grupit Hezbollah, të ndërtuara në kufirin me Libanin.

Një zëdhënës i Ushtrisë izraelite paralajmëroi libanezët të qëndrojnë larg tuneleve. Izraeli u ka kërkuar forcave paqeruajtëse të

Kombeve të Bashkuara t'i shkatërrojnë tunelet në anën libaneze. Një rezolutë e Këshillit të Sigurimit që i dha fund luftës së vitit 2006 mes

Izraelit dhe Hezbollahut, i bën thirrje Libanit ta mbajë Hezbollahun dhe grupet e tjera militante, larg kufirit izraelit.





# BeyAb for bread


Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.



**E rrallë**

## Turizmi vullkanik, një fenomen i ri shqetësues

Turistët në kërkim të adrenalinës po rrezikojnë veten dhe po pengojnë shërbimet e emergjencave duke iu drejtuar vullkaneve kur ata shpërthejnë. Një raport nga shoqëria mbretërore gjeografike paralajmëron për rreziqet në rritje të shkaktuara nga turizmi vullkanik. Autoritetet e emergjencave në vende si Islanda, tani po përballen edhe me fluksin e turistëve që derdhen atje për të



parë nga afër një shpërthim vullkani. Studimi thotë se turistët të tillë nuk e kuptojnë seriozitetin e rrezikut.

## BARSOLETA E DITËS



**Beni:** Gjyshe ime di anglisht.  
**Miri:** S'ka shans.  
**Beni:** Dëshiron ta pyesim?  
**Miri:** Po.  
**Beni:** Gjyshe, çfarë do të thotë "I don't know"?  
**Gjyshja:** Nuk e di!  
**Beni:** Hë Miri, e sheh që di anglisht?!




## Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

### “ALPHA” 3D,

Aventure/Drame/Familjar; 1 ore 36 min

**Rolet:** Kodi Smit-McPhee, Jóhannes Haukur Jóhannesson  
**Regjia:** Albert Hughes

Vetëm gjatë vikendit në ora 14:00



Në ora 16:00

### “JOHNNY ENGLISH STRIKES AGAIN”

Aksion/Aventure/Komedi; 1 ore 28 min

**Rolet:** Rowan Atkinson, Olga Kurylenko, Emma Thompson, Ben Miller, Miranda Hennesy, Jake Lacy, etj.  
**Regjia:** David Kerr



Në ora 18:00

### “NIGHT SCHOOL”

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Kevin Hart, Tiffany Haddish, Rob Riggle, Taran Killam, Romany Malco, etj.  
**Regjia:** Malcolm D. Lee



Në ora 20:00

### “SIBERIA”,

Komedi; 1 ore 51 min

**Rolet:** Keanu Reeves, Ana Ularu, Pasha D. Lynchnikoff, James Gracie, Eugene Lipinski, Rafael Petardi, Veronica Ferres, Molly Ringwald, etj.  
**Regjia:** Matthew Ross



Në ora 22:00

### “VENOM” 3D,

Aksion/Horror/Fantastiko-Shkencor; 1 ore 52 min

**Rolet:** Tom Hardy, Michelle Williams, Riz Ahmed, Scott Haze, Reid Scott, etj.  
**Regjia:** Ruben Fleischer  
Based on the Marvel Comics



**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**

## FOTO E DITES



Lëkurat e mandarinës duke u tharë nën diell në një shesh lojërash të një banese të qeverisë në Hong Kong. /AFP/

## E jashtëzakonshme

## Turistët në Antalya shijojnë në të njëjtën ditë detin dhe borën



Antalya, një nga destinacionet turistike më të njohura në Turqi, po edhe më gjerë, ua ofron vizitorëve mundësinë për të shijuar katër stinë brenda një

dite, raporton AA. Plazhi i njohur Konyaalti, perla e Antalisë, edhe në muajt e fundit të vitit tërheq turistë të huaj që duan t'i shijojnë rrezet e diellit dhe

detin në dhjetor. Në të njëjtën kohë, në malin Tahtali, 2 365 metra i lartë dhe rreth një orë larg, vizitorët kanë mundësi ta shijojnë edhe borën.



### DASHI

Shumë herë me atë që thoni dhe bëni i çoni


njerëzit të mendojnë ndryshe për ju. Kjo gjë ju intrigon dhe e bëni herë pas here.



### DEMI

Dikush po përpiket t'ju hapë sytë dhe t'ju tregojë

atë që duhet të bëni. Mundohuni ta ruani intimitetin brenda dyerve të shtëpisë.



### BINJAKËT

Sot vini në plan të parë zemrën tuaj

dhe veproni siç ju thotë ajo. Mos merrni për bazë paragjykimet e të tjerëve.



### GAFORRJA

Sot duhet t'i tregoni partnerit që do t'i gjendeni

gjithmonë pranë, edhe në ato çaste që duket sikur jeni larguar.



### LUANI

Një marrëdhënie e caktuar mund të

shkojë shumë më mirë nga sa e mendoni, nëse ju u lini hapësirë personave të tjerë t'ju gjenden pranë.



### VIRGJËRËSHA

Duhet të jeni pak më të

ashpër me persona të caktuar sepse ju kanë vënë përballë problemesh që do t'ju rëndojnë shumë sot.



### PESHORJA

Do të kujtoheni në çast të fundit për një

porosi që ju kanë lënë. Harresa juaj do të bëjë që një miqësi e vjetër të lëkundet.



### AKREPI

Nëse ende nuk e keni kuptuar se

çfarë duhet të bëni, mbase është mirë që të kërkonti ndihmë te personat që keni pranë.



### SHIGJETARI

Sot jeni të bindur që po veproni

mirë lidhur me një çështje të caktuar. Koha do të tregojë nëse keni pasur vërtet të drejtë.



### BRICJAPI

Është mirë të filloni ta merrni më

seriozisht anën emocionale tuajën. Kjo ju ndikon në gjithçka që do të bëni më vonë.



### UJORI

Vini në punë intuitën tuaj dhe

zgjidhni mënyrën dhe rrugën më të thjeshtë për të dalë në përfundim të një situatë që ka ngecur prej kohësh.



### PESHQIT

Sot do të gjendeni përballë

një problemi që ka të bëjë me punën tuaj. Nuk duhet ta lini pas dore.

## DiCaprio dhuron 100 milionë dollarë për t'i luftuar ndryshimet klimatike



**F**ondacioni i njohur i Leonardo DiCaprios ka dhuruar 100 milionë dollarë për të ndihmuar në luftën kundër ndryshimeve klimatike. Aktori 44-vjeçar krijoi fondacionin bamirës në vitin 1998 për ta informuar mbi mjedisin dhe organizon çdo vit


ngjarje me yje të mëdha për mbledhjen e të ardhurave. Gjatë dy dekadave të fundit ai ka mbështetur mbi 200 projekte të fokusuara te mjedisi, mbrojtja e kafshëve të rrezikuara nga zhdukja, duke rivendosur ekuilibrin ndaj ekosistemeve dhe komuniteteve të kërcënuara.

## Travisi paralajmëron surprizë të madhe për Kylie Jennerin



**T**ravis Scott dhe Kylie Jenner e kanë vërtetuar disa herë sa të dashuruar janë me njëri-tjetrin, por ende nuk kanë vendosur për një ceremoni tradicionale. Vetë reperi 26-vjeçar ka zbuluar se një gjë e tillë do të vijë shumë shpejt. "Ne do të martohemi së shpejti. Thjesht duhet të bëhem i guximshëm, do t'i

propozoj në një mënyrë shumë të veçantë. Ne ishim thjesht dy fëmijë. Ndoshta javën e parë nuk e di nëse është e vërtetë apo diçka e kotë. Pastaj javën e dytë mendon: 'Whoa, unë jam akoma duke folur me të, ajo më përgjigjet, unë i përgjigjem'", ka thënë Travis në intervistën për "Rolling Stones".



## Beckhami, bisedime sekrete për të udhëtuar në hapësirë

**D**avid Beckham po mendon të udhëtojë në hapësirë. Sipas medieve britanike, 43-vjeçari është në bisedime e sipër dhe synon që të bëhet futbollisti i parë që udhëton në hapësirë. "Është diçka për të cilën Beckhami ka folur për një kohë të gjatë. Është disku-

tuar në të kaluarën, por tani udhëtimi hapësinor po bëhet një perspektivë realiste. Mund të bëhet një realitet, megjithëse Davidi është shumë nervoz", kanë treguar burime për mediet britanike. Marka të mëdha janë të gatshme të paguajnë për udhëtimin e tij kozmik.

## Michelle Obama me çizme 4 000 dollarë në emision



**M**ichelle Obama ka qenë në qendër të vëmendjes gjithmonë si ish-Zonja e Parë amerikane. Por këtë herë sytë kanë qenë drejt saj për shkak të stilit të saj të veshurisë që ka ndryshuar shumë në

krahasim me vitet e shkuara. Ajo u shfaq në emisionin e Jessica Parker për ta promovuar librin e saj "Becoming" e veshur me një palë çizme të gjatë të Balenciaga. Dhe çizmet e Michele kushtojnë 4 000 dollarë.



		<b>Autor: GAZMEND MORINA</b>		IRNOSET (bised.)	CIGAN ENDACAK, ARIXHI	FABRIKAT E MEKANIZU-ARA	KRAHINË NË SHQIPËRI	SKUADËR	LLOJ VETURE JAPONEZE	<b>EPOKA E RE</b>	STADIUM I MADH NË BRAZIL	EMPOLI, GROSETO	NOTË MUZIKORE	BASHKIM QELIZASH TË NJËLLOJTA (shq.)
		KRYETAR I NJË MANASTIRI TË MURGJVE ORTODOKSË								FUTBOLLISTI LIONEL ....				
		RRUSH KO-KËRRGJATË, I KUQ A I ZI DHE ME CIPË TË TRASHË								NIS TË ZBARDHË DITA BEKIMI				
		E MBARUAR, E PËRFUNDUAR										DY BASHKË-TINGËLLORE DREJTIM		
		NGJYRË E FYTYRËS					PRIMITIV AKTORJA AMERIKANE PORTMAN (shqip.)						INTER LLOJ BIME QË PËRDORET SI ERËZ PËR GJELLË	
<b>EPOKA E RE</b>		LOCAL AREA NETWORK AKTORJA JONË IRENA						SMIRË KRIJIM, GJË E SHPIKUR NGA MENDJA						RITUALET
		BASHKËT.			GOTË PREJ BAKRI KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE					HEROI .... MEHA FUTBOLLISTI HOLANDEZ RAFAEL ... DER VART				
		ALYSSA MILANO				PJESË E EPËRME E DHOMËS SHARRËZ						GABRIEL IGLESIAS FUTBOLLISTI ARGJENTINAS HAVIER .....		
<b>EPOKA E RE</b>	PJESË E MEKANIKËS QË STUDION LIGJET E LËVIZJES SË TRUPAVE	FAZA	KËNGËTARJA .... ZYMERI	ISH ATLETJA E SHQUAR MERLIN	NORA ISTREFI	FATKEQËSI E MADHE, KOB (shq.)					NITROJEN ZAKON			
QENIE MBINJ-ERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË (mit.)						KËNGËTARJA NË FOTO ..... TAHIRI						NËNË (turq.) ISMET TOTO		
PARA TË NËNTIT						VLERËSIM ME NOTË SHTET I MADH NË AMERIKËN VERIORE				LETRARI MEHMETI NGATËRRESA E MADHE			TREVISO BËRJE MË I RI	
SHEGA					SHTET I MADH NË AZI KUNDREJT BASHKËTIN-GËLLORE			PA U NXITUAR, NGADALË (turq.)	I SHËMTUAR (bised.) HARK, KTHESE					BURG KU MBAHESHIN DËNIMET E RËNDA
VËLLAI I MADH				ZENEL AHMETI VIJË E PËRKULUR SI LAK (gjeom.)		JETËSHKR-IMET BABAI						"... TAK" DASH QË E KA TURIRIN TË BARDHË E ME PIKLA SI TË KUQE		
MARK ANTONI			LUMË NË SHQIPËRI KËNGËTARI SHAQIRI (shq.)				VEZAK				BALTË E QULLËT, GJANË (shq.) TROPOJA			
ZANORE		FLEGËR EMËR MASHKULLI TURK (shq.)					I GJYMTI DHËNIE E NJË ÇMIMI TË LARTË						"IZMIR" KOPJIMET	
RRËSHQANOR I MADH (zool.)							BASHKËT. RRËMUJË		JEMENI DY BASHKË-TINGËLLORE		HUMORIST I YNI MUAJ I VITIT			
BEND I YNI MUZIKOR						ALI ASLLANI RAST		BANJË ALLATURKA ENDE						MOLDE QYTET SHQIPTAR NË MAL TË ZI
<b>EPOKA E RE</b>	GËZIM I MADH QË ËSHTË LARA-LARA NË TRUP					ISH FUTBOLLISTI FRANCEZ LILIAN ..... VISHET ME BAR				KËNGËTARJA .... TAKE AGJENCIONI EVROPIAN				
BANORE E LABËRISË					PRESIDENTI AMERIKAN OBAMA KËNGËTARE E NJOHUR Ë SHQIPËRI				ADEM JASHARI RAMADAN AVDIU			HISTORIANI ROMAK LUKRECI ARKË SHUMË E VOGËL PREJ DRURI		
KYÇI				PRINCIPIELE DJALI KUNDREJT PRINDËRVE (pashq.)							LLOJ PEME TROPIKALE (pashq.) TENISTJA CLIJSTERS			SHTEG
RIFAT ISMAJLI			ELEMENT KIMIK BELGJIKA, AUSTRIA								BIXHOZ RENS ISTVUD			
ZANORE		DY DUKURI QË KANË NDËRMJET TYRE LIDHJE TË DYANSHME LECCE					RESHAT ARBANA TRIERI		KALORËS MESJETAR BASHKËT.					
VEGËL MUZIKORE								KUFIZIM						





**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN  
SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri

Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE

BOURNEMOUTH - BRIGHTON

1

NEWCASTLE - FULHAM

1

DERBY - BRISTOL CITY

1

# Rogova: Rikthimi në Superligë, primar

Dardan Rogova ka thënë për "Epokën e re" se Vëllaznimi synim kryesor ka rikthimin në Superligë, kurse 'hyzmetin' do t'ia bëjë edhe garës për Kupë, ku në çerekfinale do ta ketë përballë skuadrën e Dritës. "Synimi ynë primar është rikthimi në Superligë, por do të përgatitemi në maksimum të kalojmë tutje edhe për Kupë. Kemi skuadër që nuk dorëzohet përballë asnjë kundërshtari", ka thënë Rogova



EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 21 DHJETOR** - KF Vëllaznimi është në garë për t'u rikthyer në IPKO Superligën e Kosovës në futboll ani pse rezultatet e arritura në sezonin vjeshtor nuk kanë qenë edhe aq të mira. Kjo skuadër është kualifikuar edhe në çerekfinale të Kupës, por sulmuesi Dardan Rogova ka thënë për "Epokën e re" se synim primar i skuadrës kuqezi është rikthimi në elitë. "Synimi ynë primar është rikthimi në Superligë, por do të përgatitemi në maksimum të kalojmë tutje edhe për Kupë. Kemi skuadër që nuk dorëzohet përballë asnjë kundërshtari", ka thënë Rogova. Duke folur për kundërshtarin në

fazën e çerekfinale të Kupës, sulmuesi e pranon se do të jetë vështirë ndaj kampionëve aktualë por, sipas tij, edhe Dritën e pret një punë shumë e vështirë në ndeshjen që zhvillohet në Gjakovë. "Normalisht se nuk do ta kemi aspak të lehtë, pasi kundërshtar në çerekfinale e kemi skuadrën e Dritës, e cila nuk do ta ketë të lehtë për faktin se stadiumi do të jetë i stërmbushur dhe ne jemi të fortë si vendës", ka shtuar ai. Sulmuesi që është ndër lojtarët me përvojën më të madhe në skuadrën gjakovare foli edhe për rezultatet e arritura në sezonin vjeshtor, duke pranuar se pritshmeritë kanë qenë më të mëdha. "Vetë fakti që jemi në pozitën e pestë në tabelë tregon që s'kemi arritur rezultate pozitive dhe nuk i kemi arritur synimet që kishim në

fillim të kampionatit. Në pranverë do të jetë krejt ndryshe, pasi do të sjellim përforsime dhe do të jemi ndër favoritët kryesor për t'u rikthyer në Superligë", ka deklaruar ai. Sulmuesi Dardan Rogova ka folur për ish-trajnerin e Vëllaznimit, Gani Sejdiu dhe trajnerin aktual Ismet Munishin. "Shumë respekt për trajnerin Gani Sejdiu pasi ka bërë një punë të shkëlqyeshme, por fati i ka munguar. Me ardhjen e Ismetit besoj se do jetë ndryshe për vetë faktin se ligji i futbollit është që kur ndryshohet trajneri normal shumë gjera ndryshojnë në atë klub", ka shtuar Rogova. Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova sezonin vjeshtor e mbylli në pozitën e pestë me 29 pikë, ku nga 16 ndeshje ka regjistruar tetë fitore, pesë barazime dhe tri humbje.

SHKURT

## Klea Vrella dhe Elba Kokaj po përgatiten për garën e Turqisë

Dy skitaret e Ekipit Olimpik të Kosovës, Elba Kokaj dhe Klea Vrella, prej 16 dhjetorit janë duke u përgatitur në Qendrën Skitare Erzurum të Turqisë. Të dyja skitaret do ta përfaqësojnë vendin tonë në Festivalin Olimpik Evropian për të rinj, që mbahet prej 9-16 shkurt 2019 në Sarajevë dhe Sarajevën Lindore të Bosnjë e Hercegovinës. Përgatitjet e skitareve janë mundësuar nga Komiteti Olimpik i Kosovës. Elba dhe Klea do të qëndrojnë deri më 24 dhjetor në Erzurum, kurse tri ditë do të kenë gara në nivel të Federatës Ndërkombëtare të Skitarisë (FIS), në disiplinat sllallom dhe sllallom i madh. Pikërisht në këto dy disiplina, Klea dhe Elba do të garojnë edhe në EYOF Sarajeva 2019. Kosova është në mesin e 48 shteteve të Evropës që do të marrë pjesë në EYOF Sarajeva & Sarajeva Lindore 2019. Për herë të parë në EYOF-in dimëror, KOK-u u paraqit në Erzurum 2017.

## Lullaku shënoi dhe asistoi ndaj Astras

Sulmuesi shqiptar Azdren Lullaku e mbyll në mënyrën më të mirë vitin 2018. Sulmuesi kuqezi i hapi rrugën suksesit të thellë me shifrat 4-1 Astra Giurgiu ndaj gjigantëve rumunë të Dinamos së Bukureshtit. I aktivizuar titullar, numri 10 i Astras realizoi një gol spektakolar me një goditje nga distanca që në minutën e shtatë, ndërsa për t'ia bërë gjërat më të thjeshta Astras mendoi sërish Lullaku që në minutën e 36 i asistoi shokut të skuadrës Bus për rezultatit 2-0. Për Lullakun ky ishte goli i pestë në kampionat dhe asistimi i tretë.

## Ramosi flet për Mourinhon dhe Ronaldon

Kapiteni i Real Madridit, Sergio Ramos, ka thënë se nuk është kapiteni ai që vendos se kush do të bëhet trajner i Realit. Ai foli edhe për Cristiano Ronaldon, i cili gjatë verës u transferua në Juventus. "Nuk e kemi dëgjuar të flasë për Realin. Për sa kohë ai ishte këtu, grupi ndryshoi shumë pak dhe kjo ishte forca jonë. Na vjen mirë që po i ecën mbarë në Itali. Kemi pesë vjet pa Mourinhon dhe ende po flasim për të. Kemi shansin të fitojmë një trofe dhe ende flasim për Mourinhon. Nuk vendos kapiteni kush bëhet trajner", ka thënë Ramos.

## West Hami i ofron kontratë Nasrit

Në muajin dhjetor përfundon edhe pezullimi 18-mujor për përdorim doping, për yllin francez Samir Nasri, i cili prej disa muajsh është stërvitur me skuadrën angleze të West Hamit. Së fundi, kjo skuadër ka vendosur t'i ofrojë një kontratë fantazistit francez për të paktën gjashtë muajt e ardhshëm, duke ruajtur edhe një opsion për ta zgjatur bashkëpunimin edhe për vitet e ardhshme. 31-vjeçari ka një karrierë të pasur, pasi ka luajtur më herët me skuadra si Arsenal, Manchester City dhe Sevilla.

## FBK-ja emëroi përzgjedhësit e përfaqësuesëve të reja

